

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	"Mrekullia" e eksporteve zgjat vetëm një muaj, fasoni rënie e pandalshme
ADRESA	https://boldnews.al/2026/09/17/mrekullia-e-eksporteve-zgjat-vetem-nje-muaj-fasoni-renie-e-pandalshme/
BURIMI	boldnews.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	17 shtator 2026, 10:20:55 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	17 shtator 2026, 10:20:06 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	d780eec286f588d7e54f110a40011a2028ea0039cc81b1e9f3edfd9a85341e29
TEKSTI	0dca7f676d105d7c9a19b5f40c4156af43472ca085d2be62213d012009444d9b
PAMJA	1a901e4ce015ea21518cff03f4306fb670d6886cd8a598ca40e40263560ce6d5

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	e95367cd7a4cea916cc8ec8fa73c63892795e1a4e2d6eee3977ae181058c23d4
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	aa9e18560c1a0d5b17c6b891acdb8aec89255b460c70dc766ecaf13d039759d
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/e95367cd7a4cea916cc8ec8fa73c63892795e1a4e2d6eee3977ae181058c23d4>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Fillimi > AKTUALITET

“Mrekullia” e eksporteve zgjat vetëm një muaj, fasoni rënie e pandalshme

12:20 : 17/09/2026 në AKTUALITET, EKONOMI



Pas një rritjeje prej 10.6% në korrik, që u interpretua nga institucionet si një zhvillim pozitiv, që tregon diversifikimin e eksporteve nga sektorët tradicionalë të ato me vlerë të shtuar, gushti e ka zbehur këtë eufori, që në fakt ishte e lidhur me faktorë rastësorë, si konjunktura e favorshme e çmimeve në bursat jashtë dhe grumbullimi i dërgesave të disa muajve nga eksportuesit e lëndëve të para natyrore të vendit.

Të dhënat e INSTAT bëjnë të ditur se në gusht, eksportet u rritën me vetëm 1.6% e ndikuar nga performanca e dobët e tekstileve dhe këpucëve dhe rritja më e dobët e materialeve të ndërtimit e metaleve dhe mineraleve e lëndëve djegëse e energjisë, që dhanë efektin e fortë në korrik. Kjo është performanca më e dobët që nga fillimi i vitit, ku në janar e shkurt eksportet e nisën me rënie të lehtë, për tu rikuperuar më pas.

Grupi i “Tekstile dhe këpucë”, që është punëdhënësi më i madh në industri me rreth 50 mijë persona, ka zbritur në vend të dytë, i ndikuar nga rënia e pandalshme e aktivitetit. Në gusht “minerale, lëndë djegëse dhe energji”, një sektor që varet nga ecuria e çmimeve, kaluan si grupi më i madh eksportues në vend.

Sipas INSTAT, Në Gusht 2026 eksportet e mallrave arritën vlerën 20,5 mld lekë, duke u rritur me 1,6%, në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë dhe duke u ulur me 39,0%, në krahasim me Korrik 2026.

Lexo edhe:

[“175 mijë familje po paguajnë çmimin”, Tabaku: Qeveria po shkatërron fasonët](#)

[Industria e veshje-këpucëve në alarm, bie motori i eksporteve](#)

Gjatë muajit Gusht 2026, në rritjen e eksporteve prej 1,6%, pozitivisht kanë ndikuar grupet: “Materiale ndërtimi dhe metale” dhe “Ushqime, pije, duhan” me nga +1,3 pikë përqindje, “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” me +0,7 pikë përqindje, ndërsa negativisht kanë ndikuar grupet: “Tekstile dhe këpucë” me -2,9 pikë përqindje dhe “Produkte kimike dhe plastike” me -0,6 pikë përqindje.

TË GJITHA



“Mrekullia” e eksporteve zgjat vetëm një muaj, fasoni rënie e pandalshme

12:20 : 17/09/2026



Protestuesit zhvendosen sërish pranë Kuvendit: Qeveri e krimin, ju erdhi fundi!

12:11 : 17/09/2026



Kërcënohet me jetë ministri italian i Arsimit, Giuseppe Valditara merr zarf me plumb

12:08 : 17/09/2026



Eksperti i së drejtës ndërkombëtare: Aktgjykimi mund të sfidohet si në fakte, ashtu edhe në ligj

12:07 : 17/09/2026



Noka në Kuvend: Rama të japë llogari për presionin ndaj Kosovës për votimin e Gjykatës Speciale

11:58 : 17/09/2026



Protestuesit shkulin gardhin metalik te Ministria e Brendshme, tentojnë të çajjnë kordonin e policisë

11:55 : 17/09/2026



Tensionet te ministria e Brendshme, shoqërohet një protestues

11:42 : 17/09/2026

Për 8- mujorin, tendenca vijoi të ishte pozitive. Sipas INSTAT, për periudhën janar-gusht 2026, eksportet ishin 248 miliardë lekë, me rritje 6.3 me bazë vjetore (nga 6.7% që ishte zgjerimi për 7 mujorin). Edhe për 8- mujorin, ndikimin kryesor pozitiv e dhanë mineralet lëndë djegëse e energji, materiale ndërtimi dhe makineri e pjesë këmbimi, ndërsa efekti më negativ ishte nga tekstilet e këpucë.

Fasoni, vijon më rënie të fortë

Eksportet nga industria e veshjeve dhe këpucëve kanë shënuar muaj radhazi me rënie. Në gusht rënia ishte -12.4%, pas tkurrjes me mbi 13% në korrik. Për gjithë 8 mujorin eksportet ishin 64 miliardë lekë, me tkurrije 8%, duke qenë i vetmi grup i madh me tendencë negative.

Si rrjedhojë e tkurrjes së vazhdueshme, tekstilet dhe këpucë kanë kaluar në gusht në grupin e dytë më të madh në vend, me 25.8% të totalit, nga 30% që kryesonin në të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Florjan Zekja, Kryetar i Shoqatës së Manufakturës thotë se për të kuptuar përmasat e rënies së sektorit dhe perspektivën gjithnjë e më shqetësuese të tij, mjafton të përmendim disa fakte domethënëse.

“Për herë të parë në historinë e eksporteve shqiptare, grupi i tekstileve dhe këpucëve nuk renditet më në vendin e parë. Një sektor që për dekada ka qenë motori kryesor i eksporteve, punësimit dhe zhvillimit ekonomik në shumë zona të vendit, po humbet me shpejtësi peshën dhe konkurrueshmërinë e tij.

Numri i të punësuarve ka rënë nga rreth 65 mijë në vetëm 40 mijë. Kjo do të thotë se brenda pak vitesh janë humbur afërsisht 25 mijë vende pune, kryesisht për gra dhe vajza, por edhe për familje që kanë pasur industrinë prodhuese si burimin kryesor të të ardhurave.

Po aq shqetësuese është edhe rënia e eksporteve: nga rreth 1.4 miliardë euro në vitin 2022, në vetëm 960 milionë euro në vitin 2025. Pra, sektori ka humbur rreth 440 milionë euro eksporte në vetëm tre vjet, duke dëmtuar jo vetëm kompanitë prodhuese, por edhe ekonominë kombëtare dhe bilancin tregtar të vendit”.

Ai shton se një nga shkaqet kryesore të rënies është zhvlerësimi i fortë i euros, nga rreth 119 lekë në vitin 2022 në afro 91 lekë në vitin 2026. Për kompanitë eksportuese, të cilat arkëtojnë në euro, ndërsa pjesën më të madhe të kostove e paguajnë në lekë, kjo ka sjellë një goditje të drejtpërdrejtë në të ardhura, fitime dhe aftësinë për të ruajtur vendet e punës.

“Kësaj i shtohen rritja e kostove të prodhimit, mungesa e fuqisë punëtore, konkurrenca e vendeve të rajonit dhe, mbi të gjitha, mungesa e vëmendjes dhe e politikave konkrete mbështetëse nga qeveria. Ndërsa vendet e tjera subvencionojnë prodhimin, investimet dhe punësimin, bizneset shqiptare vazhdojnë ta përballojnë të vetme krizën”.

Zekja paralajmëron se nëse nuk merren masa të shpejta dhe konkrete, e ardhmja e sektorit do të bëhet gjithnjë e më problematike. Rrezikojmë mbylljen e kompanive të tjera, humbjen e mijëra vendeve të punës dhe largimin përfundimtar të kontratave e markave të huaja nga Shqipëria. “Mbrojtja dhe transformimi i sektorit prodhues nuk janë më vetëm një kërkesë e biznesit, por një domosdoshmëri ekonomike dhe sociale për vendin”, thekson ai.

Ngadalësohet dhe energjia e lëndët djegëse

Ndërsa fasoni është ndikuar negativisht nga lufta, e kundërta ka ndodhur me eksportet e lëndëve djegëse, që u favorizuan nga rritja e çmimeve në bursa.

Megjithatë, gushti ka qenë më i qetë. Grupi “Minerale. Lëndë djegëse, energji” ka eksportuar 5.2 miliardë lekë në gusht 2026, me një rritje prej 2.7% me bazë vjetore, pas zgjerimit me 32% në korrik. Grupi ka kaluar në vend të parë në korrik, me 25% të totalit.

Për 8 mujorin, ky grup ka eksportuar 54.4 miliardë lekë, me zgjerim vjetor prej 21%. Për 8 mujorin, ky grup ka vijuar të jetë i dyti më i madh në vend, me rreth 22% të totalit.

Ushqime pije e duhan me rritje

“Ushqime pije e duhan”, një nga grupet me ecurinë më të mirë vitet e fundit dhe një nga dy sektorët që ka shënuar rritje në 2026-n, është përmirësuar në gusht, duke u rritur me 8%. Për tetë mujorin, grupi është zgjeruar me 3.4%. Ky grup ka kaluar në të tretin më të madh në vend, me 15.8% të totalit.

Zbehet lulëzimi i Materiale ndërtimi e metale

Gjatë muajit korrik, grupi i “Materialet e ndërtimit dhe metalet” shënoi një rritje të fortë me mbi 70% duke qenë faktori kryesor i ndikimit në zgjerimin me mbi 10% të eksporteve. Arsyeja kryesore u lidh me faktin që eksportuesi i kromit Albchrome, që hyn në këtë grup, kishte nisur një ngarkesë me prodhimin e disa muajve drejt SHBA-ve.

Në gusht, ky grup u ngadalësua, duke u rritur me 10.4%. Për 8- mujorin, eksportet u rritën 21.4%, duke mbetur grupi me ndikimin më pozitiv të ecurisë së eksporteve për 8 mujorin, së bashku me mineralet, lëndët djegëse e energjinë.

Ngec Industria mbështetëse automotive në gusht

“Makineri, pajisje, pjesë këmbimi” ishte grupi me ecurinë më pozitive në gjashtë 7-mujorin, me zgjerim prej 13.5%. megjithatë në gusht u shfaqën shenja ngadalësimi, me shitjet e këtij sektori jashtë vendit, që u rritën me vetëm 0.1%. për 8 mujorin, grupi është rritur me 12%.

Ky grup, ku peshën kryesore e mban industria automotive është rimëkëmbur që në fund të vitit të kaluar kur kompanitë raportuan se porositë erdhën në rritje. Një pjesë e kompanive prodhojnë pjesë të thjeshta për makinë pune dhe mjete të mëdha transporti një segment që ka qenë në ecuri të qëndrueshme.

Ndërkohë vendimi i KE për të lënë mjetet me djegie të brendshme përtej 2035 në formë hibride, ndryshoi panoramën edhe për këtë vit ku porositë pritet të jenë në rritje. Presionet kryesore që kjo industri e vendosur në vendin tonë po kalon lidhen me fuqinë punëtore, zhvlerësimin e vazhdueshëm të euros pasi kontratat e tyre janë fikse disavjeçare dhe së treti rritja e beftë e pagës minimale në 50 mijë lekë.

Rritet deficit tregtar

Në Gusht 2026 eksportet e mallrave arritën vlerën 20,5 mld lekë, duke u rritur me 1,6%, në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë dhe duke u ulur me 39,0%, në krahasim me Korrik 2026.

Importet e mallrave arritën vlerën 75,6 mld lekë, duke u rritur me 12,6%, në krahasim me një vit më parë dhe duke u ulur me 12,6%, në krahasim me Korrik 2026. Defiçiti tregtar i këtij muaji është 55,0 mld lekë, duke u rritur me 17,4%, krahasuar me një vit më parë dhe me 4,3%, në krahasim me Korrik 2026.





Ecuria e tregtisë së mallrave sipas vendeve partnere

Në muajin Gusht 2026, vendet me të cilat Shqipëria ka pasur rritjen më të madhe të eksporteve, në krahasim me Gusht 2025 janë: Italia (5,0%), Kosova (1,5%), etj. Ndërsa vendet me të cilat eksportet kanë pasur rënien më të madhe, janë: Turqia (54,1%), Maqedonia e Veriut (5,6%), etj.

Në muajin Gusht 2026, vendet me të cilat Shqipëria ka pasur rritjen më të madhe të importeve, në krahasim me Gusht 2025 janë: Italia (2,2%), Kina (16,9%), etj. Ndërsa vendet me të cilat importet kanë pasur rënien më të madhe, janë: Greqia (3,4%), Gjermania (3,6%), etj.

Shkëmbimet tregtare me vendet e BE-së zënë 46,2%, të gjithë tregtisë. Në Gusht 2026, eksportet drejt vendeve të BE-së zënë 63,1% të eksporteve gjithsej dhe importet nga vendet e BE-së zënë 41,6%, të importeve gjithsej./ Monitor






Etiketa: eksporte fasoneri

Lajme të lidhura



"175 mijë familje po paguajnë çmimin", Tabaku: Qeveria po shkatërron fasonet
 10:20 : 04/08/2026



Industria e veshje-këpucëve në alarm, bie motori i eksporteve
 10:43 : 20/07/2026



Rritje e vakët e prodhimit të mishit/ Shqipëria importoi mbi 8 miliardë lekë gjatë 2025
 22:53 : 26/06/2026



Turqia e shpeshë shpërndet në



Fëmijë "shkatërrues" fasoni



Shëndeti i fasonit (8)

negua e jashtme, eksportet për muajin maj u rritën 3%, importet arritën 81 mld lekë

🕒 20:03 : 17/06/2026

Curio Shkollën e Tasovit, eksportet bien 14% në maj, fabrikat po mbyllen, lënë punonjësit pa punë

🕒 12:59 : 17/06/2026

Oranua me tasovet me 'Invest' në Durrës, dhjetëra punonjësve u mbahen pagat

🕒 10:40 : 25/04/2026



RRETH NESH

Boldnews.al mbetet zgjedhja e parë për një lexues i cili kërkon të informohet me saktësi për një lajm. Misioni jonë kryesor është paanshëmëria dhe profesionalizmi dhe për këtë janë të punësuar gazetarët më të mirë në tregun mediatik.

Media e re e shprehur në WebP

NA NDIQ



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.